

VENDIM
Nr.86, datë 17.7.2008

PËR NDRYSHIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “DARDANIA ENERGJI” SHPK

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 15 të “Rregullores për procedurat e licencimit”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007 dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.42, datë 11.4.2008 “Për fillimin e procedurave për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike me nr.10, seria PV03P”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.7.2008, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë EN-KU sh.p.k., për ndryshimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike me nr.10, seria PV03P, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.20, datë 19.12.2003 shoqërisë Dardania Energji sh.p.k., dhe konstatoi paraqitjen e plotë nga shoqëria “EN-KU” sh.p.k., të dokumentacionit të kërkuar nga ERE, si dhe shprehjen juridikisht të vullnetit të shoqërisë “Dardania Energji” sh.p.k., për kryerjen e ndryshimeve në licencën e lëshuar kësaj shoqërie,

VENDOSI:

1. Të miratoj kërkesën e shoqërisë EN-KU sh.p.k., për ndryshimin e licencës nr.10, seria PV03P, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.20, datë 19.12.2003 shoqërisë Dardania Energji sh.p.k.

2. Në licencën me nr.10, seria PV03P, në pjesët ku përcaktohet subjekti të cilit i jepet licenca ndryshohet subjekti Dardania Energji sh.p.k. dhe vendoset emërtimi i subjektit EN-KU sh.p.k., si dhe të dhënat e kësaj shoqërie lidhur me kodin fiskal dhe certifikatën e regjistrimit.

3. Kudo ku në licencë përcaktohet Dardania Energji sh.p.k. si mbajtëse e licencës pjesët e licencës shfuqizohen dhe hyjnë në fuqi ndryshimet sipas pikës 1 të këtij vendimi.

4. Në pjesët e licencës së dhënë shoqërisë Dardania Energji sh.p.k., ku përcaktohen data e hyrjes në fuqi të licencës, në vazhdim të numrit të vendimit të përcaktuar në licencën nr.10, seria PV03P shënohen edhe ndryshimet e këtij vendimi si pasojë e vendimmarrjes së Bordit të Komisionerëve të ERE-s me datë 17.7.2008.

5. Shoqërisë EN-KU sh.p.k. t’i lëshohet licenca me përmbajtjen e ndryshuar siç përcaktohet në këtë vendim.

6. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqëritë Dardania Energji sh.p.k. dhe EN-KU sh.p.k. për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta